



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë**  
**Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të**  
**Dhunshëm dhe Luftë Kundër Terrorizmit**

**STRATEGJIA KOMBËTARE**  
**E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**  
**PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZIMIT TË**  
**DHUNSHËM**  
**(2018-2022)**

Shkup  
Shkurt 2018

Përmbajtja	
Parathënie .....	2
DEKLARATË NGA KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË .....	3
DEKLARATA E PËRBASHKËT E KOORDINATORIT KOMBËTAR DHE ZËVENDËS KOORDINATORIT KOMBËTAR TË KKPEDhLKT PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM .....	4
REZIME .....	5
PRIORITETET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT .....	7
HYRJE .....	9
KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT: KUPTIMI DHE PRANIMI I DALLIMEVE, NGJASHMËRITË DHE LIDHJET .....	9
METODOLOGJIA PËR STRATEGJITË KOMBËTARE PËR PEDH DHE LKT .....	13
TERMINOLOGJIA (FJALORTH PËRSHKRIMI I TERMEVE) .....	15
VIZIONI DHE MISIONI I PEDH DHE LKT .....	16
ANALIZA STRATEGJIKE E RRETHINËS .....	17
PËRPPJEKJET E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR TË LUFTUAR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM .....	22
ANALIZË E SITUATËS DHE SHTRIRJA E PROBLEMIT .....	22
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL .....	23
TË KUPTUARIT E KËRCËNIMIT DHE RRETHIMI I TIJ .....	24
EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE SHKAQET E TIJ RRËNJËSORE .....	26
HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM .....	27
KONTEKST DHE PROMOTOR I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM .....	27
RADIKALIZIMI NË BURGJET .....	29
NEVOJA PËR BASHKËPUNIM .....	29
PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE UDHËHEQËSVE FETAR LOKAL .....	29
INICIATIVA TË TJERA NË RRJEDHË .....	30
PRIORITETET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE .....	30
AKTORËT .....	31
KOORDINIMI DHE OPERACIONET .....	31
REZULTATET E PRITURA .....	31
ZBATIMI: PLANIFIKIMI I VEPRIMIT PËR PEDh dhe LKT .....	31
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE .....	32
AKTIVITETET SPECIFIKE PËR ZBATIM .....	33
KORNIZA DHE QASJA E PËRGJITHSHME .....	33
PRIORITIZIMI .....	34
MONITORIMI dhe VLERËSIMI PËR PEDh .....	35
RI KALIBRIMI .....	36
AGJENDA HOLISTIKE PËR VEPRIM: Planifikimi i veprimit për parandalimin "gjithëpërfshirës" të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit .....	36

## Parathënie

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me angazhimet e saj për reforma në shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë në sektorin e sigurisë, me kënaqësi e prezanton Strategjinë e saj të parë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (PEDh). Ky dokument është në përputhje me Strategjinë e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në bashkëpunim me partnerë rajonal dhe ndërkombëtarë të cilët e mbështetën Komitetin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftë kundër Terrorizmit (KKPEDhLKT) në aktivitetet e saj. Me këtë dokument, Republika e Maqedonisë synon ti koordinojë ministritë, institucionet qeveritare dhe joqeveritare në veprimin e tyre.

KKPEDhLKT shpreh falënderimin për të gjithë partnerët ndërkombëtarë, rajonalë dhe vendas, dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare të cilat dhanë mbështetje në përpilimin e Strategjisë Kombëtare të PEDh.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë shpreh gatishmëri të vazhdojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet dhe organizata për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, dhe në pajtim me Strategjinë Kombëtare dhe Plan veprimin për luftë kundër terrorizmit (LKT) me qëllim tu kundërvihet këtyre fenomeneve të sigurisë, duke e ruajtur stabilitetin dhe sovranitetin e shtetit.

KKPEDhLKT përshëndet përkushtimin dhe angazhimin e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve në krijimin e dokumenteve strategjike për PEDh dhe LKT. Është privilegj të punohet me ata në ndërtimin e themeleve për *familje të fuqishme, komunitete të fuqishme dhe shtet të fuqishëm*.

## DEKLARATË NGA KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Republika e Maqedonisë ngel e përkushtuar ndaj demokracisë, sundimit të së drejtës, respektimi të te drejtave të njeriut, dhe barazisë të të gjitha kombeve në komunitetin ndërkombëtar.

Ekspozimi i Ballkanit Perëndimor ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të cilat rezultojnë nga ekstremizmi i dhunshëm terrorist, plotësuar me fenomenin e “Luftëtarëve të huaj terrorist”, bëjnë që këto kërcënime trans nacionale dhe trans regjionale të jenë prioritetet kryesore të vendit.

Shteti jonë multietnik dhe sekular e rrit përgjegjësinë ndaj këtyre kërcënimeve, me mbështetjen e partnerëve tanë rajonal dhe ndërkombëtar.

“Pani 3-6-9” i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përpos angazhimeve të tjera për reforma në shoqëri, synon edhe drejt rritjes së kapaciteteve institucionale për përgjigje ndaj sfidave të sigurisë. Dokumentet kombëtare strategjike, edhe pse të veçanta, paraqesin mekanizma të përbashkëta dhe gjithëpërfshirëse për veprim, që përbëhen nga metoda sociologjike dhe ligjore të aq. „masa “të buta” dhe “të forta”. Me këto masa Republika e Maqedonisë siguron vegla të shumta me të aq. “SMART fuqi (inteligjente)” për të luftuar rritjen e llojeve të ndryshme të radikalizmit të cilat zakonisht çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Republika e Maqedonisë e thekson nevojën për intervenim të hershëm dhe eliminim të ideve radikale nëpërmjet shfrytëzimit të të aq. masa të buta për parandalim, por edhe masa të forta për ndjekje, për shkak të kontekstit shoqëror kompleks.

Republika e Maqedonisë ka përgjegjësi shoqërore dhe kolektive për përgjigje më të gjerë në kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet përfshirjes së aktorëve fetar, lokal, mediatik dhe arsimor.

Njëkohësisht nevojitet qasje moderne për përballje me kërcënimin nga terrorizmi me përforcimin e sigurisë nacionale dhe stabilitetit nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit rajonal me partnerët e Ballkanit dhe më gjerë.

Me qëllim siguri afatgjate, siguri, stabilitet dhe prosperitet për qytetarët e vendit tonë – vendimi për formimin e KKPEDhLKT, si dhe përpilimi i dokumenteve të reja strategjike (2018 - 2022) - bazohet për angazhimin e Republikës së Maqedonisë drejt sigurisë kolektive dhe mbrojtjes, të harmonizuar me partnerët rajonal dhe ndërkombëtar, që është provë për përkushtimin tonë bujar për:

***Familje të fuqishme, ... Komunitete të fuqishme, ... dhe Shtet i fuqishëm!***

**Shkëlqesia e Tij Zoran Zaev**  
Kryeministër i Republikës së Maqedonisë

## **DEKLARATA E PËRBASHKËT E KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR PEDHLKT DHE ZËVENDËS KOORDINATORIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Duhet të përkushtohemi në mënyrë që të jemi përgatitur dhe rezistues në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar, në angazhimet tona kolektive dhe përgjegjësi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (PEDh). Kjo do të arrihet vetëm nëpërmjet paralajmërimit të hershëm, me arsim dhe kundër – mesazhe kryesore që të ndalohet eskalimi i ekstremizmit të dhunshëm.

Republika e Maqedonisë e identifikon dhe tërësisht e pranon nevojën për qasje të ndryshme të mundshme që të kuptohet koncepti i ekstremizmit të dhunshëm, i cili mund të çojë drejt terrorizmit. Pa indikatorë të vendosur qartë, pothuajse është e pamundur detyra të përpilohet qasje drejt radikalizmit dhe dhunës politike. Disa nga sqarimet teorike më popullore dhe më gjerë të pranuar për motivimin e ekstremistëve përfshijnë teori zhvillimore, teori të kompetencës etnike dhe teori etno – kulturore në mënyrë që ti hulumtojnë promotorët dhe faktorët për padrejtësi sociale dhe jo barazi.

Gjithashtu, duhet të identifikojmë dhe pranojmë vlefshmërinë e dialogut të përhershëm ndërmjet të gjithë pjesëtarëve të grupeve fetare, etnike dhe kulturore, duke e marrë parasysh kuptimin tonë për korrelacion të drejtpërdrejtë ndërmjet mungesës së dialogut dhe rritjes së urrejtjes të rinjtë. Nevoja për trajnim më të madh për udhëheqësit fetar, duhet të bëhet prioritet shtetëror dhe kombëtar, duke pasur parasysh rolin e tyre në shoqëri dhe promovimin e praktikave fetare të shëndetshme.

Maqedonia nuk mund të mbështetet vetëm në organet e ndjekjes, për shkak se kjo strategji bazohet mbi qasje holistike me angazhim më të madh të përfaqësuesve të shoqërisë civile, me masa parandaluese, të përballem me çështjen e ekstremizmit të dhunshëm, në vend me reagimin në lidhje me pasojat e tij. Prevenimi nuk paraqet instant – zgjidhje, por proces i cili zgjat gjatë. Përpjekjet e PEDh dhe LKT nuk duhet të vështrohen si konfliktuozë, por si komplementare ndërmjet vete.

Reziqet e caktuara nga luftëtarë të huaj terrorist ngelin, shqetësim i veçantë, kryesor për vendin tonë dhe për qytetarët e saj. LHT nuk janë fenomen i ri në rajon, por, gjatë disa dekadave, numër i caktuar i shtetasve të Republikës së Maqedonisë kanë luftuar në vatrat e luftërave në më shumë shtete. Duhet të përballemi me të vërtetën se efektiviteti i përpjekjeve tona, veprimeve dhe aktiviteteve për PEDh dhe LKT dhe kërcënimet terroriste janë penguar nga mos vendosmëria e komuniteteve të marrin pjesë në iniciativat për LHT, si rezultat i tendencave të ndryshme historike për politizimin e përpjekjeve të këtilla dhe kundërshtimeve të përgjithshme për masat për LHT, si sulm mbi religjionin ose përkatësinë etnike. Kjo duhet të ndryshojë. Ndërsa kjo strategji e re dhe plan veprimi për LHT paraqet apel, si dhe thirrje për veprim për ndryshime.

Strategjia dhe Plan veprimi për kundërshtimin e formave të radikalizmit që mund të rezultojnë me ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm e reflektojnë dhe konfirmojnë përkushtimin tonë drejt qasjeve të reja, gjithëpërfshirëse, holistike, parandaluese në mënyra që mbikëqyren dhe pranohen si legjitime nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë do të ngrihemi mbi këto sfida, do të përballemi me to dhe do ti tejkalojmë me:

***Familje të fuqishme, ... Komunitete të fuqishme, ... dhe Shtet i fuqishëm!***

**Borçe Petrevski.**  
Koordinator kombëtar për PEDhLKT

**Xheladin Ajvazi**  
Zëvendës koordinator kombëtar për PEDh

## REZIME

“Ecim së bashku përpara, me besim dhe siguri.”

Borçe Petrevski.

Koordinator kombëtar për PEDhLKT

Përvoja e deritanishme tregon se strategjitë e ndryshme shpesh nuk përputhen në segmente të veçanta, gjatë çka nuk ia dalin qartë të bartin qëllimin tek institucionet dhe qytetarët, dhe nuk mundësojnë implementim efektiv të qëllimeve strategjike të planifikuara.

Edhe pse lufta kundër terrorizmit (LKT) është më ndryshe nga lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (PEDh) në mënyra të shumta dhe të rëndësishme, të dyja duhet të jenë të konceptuara dhe implementuara në mënyrë koherente, të ndërlidhur dhe strategjike, sepse kërcënimet dhe rreziqet nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë të ndërthurura dhe të ndara në mënyrë të pa ndashme. Prandaj strukturat e Strategjive Nacionale të Republikës së Maqedonisë për LKT dhe PEDh janë të harmonizuara në mënyrë esenciale, ndërsa plan veprimet përkatëse ( edhe pse janë dy dokumente të veçanta) dallohen me parime të harmonizuara dhe i përgjigjen bashkësisë së përbashkët të promotorëve dhe faktorëve.

### 1. Parime udhëzuese të përbashkëta kombëtare për PEDh dhe LKT

- Parimi i kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë,
- Parimet e sundimit të së drejtës, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, anti diskriminimi dhe fokusi në mbrojtjen e të dhënave personale,
- Parimi i mundësimit të Republikës së Maqedonisë së sigurt dhe sovrane,
- Parimi i qasjes kombëtare gjithëpërfshirëse
  - Qeveria dhe të gjitha institucionet e saj si tërësi
  - Shoqëri si tërësi
  - Ekipe funksionale / Grupe pune / Ekipe speciale
  - Bashkëpunimi ndërinstitutional
  - Transparenca
- Parimi i sundimit të mirë dhe kultivimit të vlerave demokratike,
- Parimi i respektimit të aspekteve multietnike dhe multikulturore të Republikës së Maqedonisë,
- Parimi i bashkëpunimit rajonal dhe transnacional,

### 2. Parime udhëzuese kryesore për PEDh dhe LKT


- Qytetarë të sigurt të Republikës së Maqedonisë,
- Ndërtimi i institucioneve efikase, përgjegjëse dhe inkluzive, të cilat do të mbështesin dhe zhvillojnë besimin e publikut,
- Sigurimi i kushteve për zhvillim ekonomik të përforcuar,
- Sigurimi i unitetit nacional dhe komunitete rezistuese ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm,

### 3. Promotor të përbashkët dhe faktorë të PEDh dhe LKT

- „Luftëtar të huaj terrorist”,
- Ekstremizëm etno – religjioz,
- Mosbindje dhe radikalizim,
- “Nyje” e korrupsionit, kriminalitet dhe korrupsion,

Këta faktorë të përbashkët shërbejnë si “lidhje” kontekstuale dhe përmbajtjesore ndërmjet Strategjisë kombëtare për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit në Republikën e Maqedonisë. Strategjitë janë të lidhura institucionalisht dhe në mënyrë organizative, në pajtim me “katër shtyllat” e Strategjisë Globale për PEDh dhe LKT të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe PEDh dhe LKT strategjitë e Bashkimit Evropian (BE)<sup>1</sup>.

**FIGURA 1. Integrimi gjithëpërfshirës me komunitetin ndërkombëtar**




Dy Strategjitë Nationale janë mund kolektiv i Komitetit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftë Kundër Terrorizmit ( më tutje KKPEDhLKT) të Republikës së Maqedonisë, për arritjen e kuptimit të përbashkët për qëllimet, vizionin dhe misionin kombëtar të Republikës së Maqedonisë. Anëtarët e KKPEDhLT nevojitet ti identifikojnë aftësitë, kapacitetet dhe nevojat e ministrive dhe institucioneve me qëllim siguri dhe mbrojtje të qytetarëve dhe sovranitetit të Republikës së Maqedonisë.

KKPEDhLT synon të kodifikojë kuptimin e përbashkët për mjedis strategjik, që u jep kontekst më të gjerë misionëve të PEDh dhe LKT, dhe i identifikon prioritetet, sfidat dhe mundësitë në përfundimin e kontributit të Republikës së Maqedonisë në parandalimin e manifestimeve të ardhshme të të gjitha formave të ekstremizmit dhe faktorëve që e ndihmojnë rrugën drejt terrorizmit.

<sup>1</sup> “Strategjia për Bashkimin Evropian për luftë kundër terrorizmit”, Këshilli i Bashkimit Evropian, Bruksel, 30 nëntor 2005; “Plan veprim për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm“, Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 24 dhjetor 2015; “Strategjia globale për luftë kundër terrorizmit“, Grupi special për implementimin e strategjisë për luftë kundër terrorizmit, Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2006.



FIGURA 2. Cikli i strategjisë



KKPEDhLKT ka përpunuar qëllime strategjike të përgjithshme gjithëpërfshirëse për përpjekjet e vendit në lidhje me PEDh dhe LKT:

**Qëllimi strategjik i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë për PEDh dhe LKT:**



*PARANDALO: por nëse parandalimi nuk ka sukses, NDIQ ( në mënyrë të rregulluar, pengoi, degradoi, shkatërroi dhe mposhti) kërcënimet terroriste, aleatët e tyre dhe strehimoret e tyre të sigurta në territorin e Republikës së Maqedonisë, .... njëkohësisht dhe çdo herë duke respektuar gatishmërinë për të MBROJTUR dhe tu PËRGJIGJUR kërcënimeve ndaj qytetarëve dhe infrastrukturës kritike të Republikës së Maqedonisë.*

**PRIORITETET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT**

Sfidat në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit (dhe shkaqet e tyre) kërkojnë Strategji dhe Plan veprime qartë të identifikueshme dhe tërësisht të integruara. Republika e Maqedonisë gjeti dhe miratoi harmoni esenciale dhe thelbësore ndërmjet dy Strategjive Kombëtare dhe plan veprimeve përkatëse në katër (4) **PRIORITETET STRATEGJIKE** të përbashkëta si vijon:



FIGURA 3. PRIORITETE STRATEGJIKE për PEDh dhe LKT

 **Prioritetet strategjike dhe synimet kombëtare** 

**PRIORITETET STRATEGJIKE:**

**TË PARANDALOHET....** hyrje të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe aktivistë, si dhe shkaqet rrënjësore për radikalizëm

**TË MBROHEN ...** qytetarët, prona e tyre infrastruktura kyçe dhe kritike nga të gjitha kërcënimet, që janë të pranishme dhe të qarta, si dhe kërcënimet në rritje;

**TË NDIQEN....** kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit (ndërprerje, reduktim, ndarje dhe mposhtje) në rrënjët e tyre, në strehimore dhe kudo që paraqesin kërcënim për njerëzit dhe infrastrukturën

**TË REAGOHET....** në mënyrë aktive, agresive dhe gjithmonë në një mënyrë që është transparente dhe në përputhje me sundimin e ligjit, në frymën e solidaritetit dhe në aspektin e nevojave të viktimave

Roli dhe përgjegjësia<sup>2</sup> e KKPEDhLKT është të sigurojë koordinim dhe planifikim bashkëpunues dhe veprim në më tepër nivele në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

---

<sup>2</sup> Për përshkrim më të detajuar të gjendjeve aktuale role të vazhdueshme zyrtare dhe përgjegjësi të KKPEDhLKT shih, “Vendim për themelimin e Komitetit Kombëtar për Përballje me Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Terrorizmin,” 25 korrik, 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## HYRJE

Republika e Maqedonisë ka lokacion të rëndësishëm strategjik gjeopolitik me strukturë sociale komplekse të cilat ofrojnë mundësi të ndryshme dhe sfida. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë duhet të demonstrojnë unitet në trajtimin e aktiviteteve kriminale të organizuara dhe ideologjive radikale që kërkojnë dhunë dhe rrezikojnë vlerat shoqërore dhe kushtetuese të shtetit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka një përgjegjësi sociale dhe kolektive për t'u marrë me ekstremizmin e dhunshëm dhe kërcënimet nga terrorizmi përmes qasjeve fetare, lokale, mediatike dhe arsimore, duke theksuar anët e fuqishme dhe përparësitë dhe me qëllim, ruajtjen e kohezionit të shoqërisë.

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi paraqesin kërcënim ndërkombëtar që shënon rritje, që është motivim i mjaftueshëm për nevojën e sigurisë së përmirësuar dhe përforcuar kolektive dhe bashkëpunimin institucional në planifikimin strategjik dhe implementimin e aktiviteteve në Republikën e Maqedonisë. Republika e Maqedonisë duhet ti përmbushë këto sfida të reja dhe në rritje me atë që do të ndjekë rrjetet e përshtatura kriminale dhe terroriste dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe kërcënimet të tjera të cilat mund të shkaktojnë jo stabilitet në shtet.

## **KUNDËRSHTIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT: KUPTIMI DHE PRANIMI I DALLIMEVE, NGJASHMËRITË DHE LIDHJET**

Është thelbësore të kuptohen dhe të respektohen dallimet kryesore, ngjashmëritë dhe lidhjet ndërmjet ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit me qëllim të zhvillimit të strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit gjithëpërfshirëse, të cilat në mënyrë efikase dhe të qasshme (domethënë, ekonomike) do të ndërtojnë kapacitete dhe aftës për të parandaluar fenomenet negative sociale

Shqyrtimi i kërcënimeve nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi dhe parakushtet e tyre, shkaqet rrënjësore, promotorët dhe kontekstet unike lokale- komunale, shtetërore dhe rajonale specifike për Republikën e Maqedonisë, janë bazë e rëndësishme për zhvillimin e Strategjive Kombëtare dhe Planeve të Veprimit për PEDh dhe LKT.

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë dy probleme të veçanta dhe të ndara që i kërcënohen Republikës së Maqedonisë, vendeve të Ballkanit dhe komunitetit më të gjerë ndërkombëtar. Po këto, njëkohësisht, janë dy vepra nga një “cikël” më i madh, më i gjerë dhe më i rrezikshëm i kërcënimeve.

Të dy kërcënimet, përkeqësohen si kërcënime individuale nëse nuk trajtohen herët, me nder dhe në mënyrë të vazhdueshme. Me rëndësi edhe më të madhe është të kuptohet se dy kërcënimet përkeqësohen edhe kur kundër – masat zbatohen në mënyrë jo përkatëse. Përdorimi i veglave të gabuara dhe zgjidhjet e problemin mund ta përkeqësojnë në vend që ta minimizojnë dhe zbutin.

PEDh duhet të mbikëqyret dhe të ketë qasje si ndaj një pjese komplementare nga qasja më e gjerë ndaj LKT.

**FIGURA 4. EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE TERRORIZMI**

**Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit**  
*PËRSHKRIME TË PRANUARA GJERËSISHT*

**Përshkrim i gjerë i EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM -**

**Është në lidhje me besimet dhe veprimet e njerëzve të cilët e mbështetin ose përdorin dhunën e motivuar nga ideologjia, për ti realizuar qëndrimet radikale ideologjike, religjioze ose politike.**

- ✓ Koncepti qendror i PEDh është rëndësia të adresohen "kushtet e volitshme" për përhapjen e terrorizmit
- ✓ Aktet e terrorizmit nuk mund të pengohen nëpërmjet masave represive
- ✓ Me rëndësi esenciale është të zhvillohen zgjidhje konstruktive për ankesa të cilat mund të shfrytëzohen nga grupe të ndryshme radikale ideologjike dhe mbështetësit e tyre

**Përshkrim i gjerë i TERRORIZMIT -**


**Shfrytëzim joligjor i dhunës dhe frikësimit, në veçanti kundër civilëve, në kërkim të plotësisht të qëllimeve politike.**

- ✓ Terrorizmi është krim serioz
- ✓ Nuk mundet dhe nuk duhet të lidhet me cilin do nacionalitet, religjion ose përkatësi etnike
- ✓ Disa karakteristika të shpeshta përfshijnë: rreziqe për jetën dhe pronën, përpjekje me qëllim të rrënojë qeverinë demokratike, në veçanti në përpjekje të ndikojë mbi politikën dhe ligjvënësit, dhe qasje jo diskriminuese ndaj targetimit, me qëllim të inspirojë frikë dhe terror në mesin e të gjithë popullatës

*Për çdo shoqëri funksionale nevojitet sundimi i së drejtës: hetimi, (prokuroria) ndjekja, gjykimi dhe burgosja. PEDh nuk synon ti zëvendësojë këto qasje, por ti plotësojë. Çdo qeveri që mbështetet vetëm në qasjet tradicionale kundër terrorizmit, dhe e cila nuk e plotëson sundimin e ligjit me masat që adresojnë shkaqet rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm, në fund të fundit do të rrezikonte sigurinë e vet kombëtar. PEDh nuk është opsion i butë, por **imperativ strategjik**<sup>3</sup>.*

<sup>3</sup> "National Action Plans Task Force Supporting Strategic Efforts to Prevent and Counter Violent Extremism," *Hedayah Global Center on Cooperative Security*, 23 janar 2018.

FIGURA 5. MENAXHIM ME RREZIQET



Kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit janë të kombinuara dhe të ndërthurura ndërmjet vete, ndërkaq hasen në vende të veçanta gjeopolitike brenda dhe jashtë kufijve të shteteve kombëtare (d.m.th., në hapësirat e "celulave" kryesore dhe në hapësira me rregullim të pamjaftueshëm) dhe paraqesin probleme trans nacionale dhe problemet ndër rajonale që shkojnë përtej kufijve.

Si të gjitha shtetet sovraane, Republika e Maqedonisë, çdo herë duhet të mbajë Strategji Nacionale gjithëpërfshirëse dhe Plan veprime - aftësi dhe kapacitete - për PEDh dhe LKT, si sfida dhe kërcënime të veçanta dhe individuale. Përgatitja gjithëpërfshirëse është KRYESORE.

Por, njëkohësisht, duhet të merren parasysh praktikatat e mira se sa më shumë zhvillohen, përmirësohen dhe mirëmbahen aftësitë dhe kapacitetet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm aq më pak do të duhet të përdoren kapacitetet dhe aftësitë në luftën kundër terrorizmit.

Qasja parandaluese ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është mënyra më ekonomike për t'u marrë me këtë problem, i cili nuk guxon të trajtohet pa mjaftueshëm ose tërësisht të injorohet, duke pasur parasysh se përdorimi i forcës është gjithmonë opsioni i fundit dhe jo i pari dhe i vetmi për përgjigje.

Radikalizmi vetvetiu nuk është kërcënim për shoqërinë nëse nuk lidhet me dhunë ose veprime të tjera jo ligjore, siç është për shembull nxitja e urrejtjes, e cila me ligj është përkufizuar në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>4</sup>.

*Radikalizmi terrorist*, megjithatë, është proces dinamik nëpërmjet të të cilit individ arrin në gjendje të pranojë dhunën terroriste si mënyrë të mundshme, madje edhe legjitime, të veprimit.

Nuk ka profil të vetëm i cili i përfshin të gjithë terroristët, as që ka rrugë qartë të përkufizuar që çon individin drejt terrorizmit. Shtytësit e mundshëm të radikalizmit terrorist janë të ndryshëm, kompleks dhe kombinohen në mënyrë unike në secilin nga rastet.

Profilat e ndërtuara mbi supozime stereotipike të bazuara në fenë, racën, përkatësinë etnike, gjininë, gjendjen socio-ekonomike etj. nuk janë vetëm diskriminuese, por në të njëjtën kohë janë joefektive, me rrezikun për të përkeqësuar dhe ushqyer përhapjen e dy dukurive. Për këto shkaqe esenciale duhet të refuzojmë identifikimin e terrorizmit me cilën do përkatësi nacionale, fetare, ose etnike.

Duke u mbi ndërtuar në këto parime themelore, dhe më pas edhe mbi kontekstin specifik dhe unik të sfidave dhe mundësive që paraqiten në bazën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit në Republikën e Maqedonisë, Strategjitë Nacionale paraqesin edhe përshkrim kontekstual - relevant operativ i bashkësisë së veglave gjithëpërfshirëse për PEDh dhe LKT të shtetit.

TABELA 1. Shqyrtimi i përshkrimeve të ndryshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nga perspektiva e Republikës së Maqedonisë

<b>PARANDALIMI I EKSTREMIZIMIT TË DHUNSHËM</b>
<i>“Planifikimi, vendosja dhe zbatimi i procedurave, metodave dhe masave për parandalim, detektim dhe kundërshtim të jo tolerancës, urrejtjes dhe diskriminimit kundër grupeve të tjera sociale.”</i>
<i>“Krijimi dhe zbatimi i masave dhe aktiviteteve për identifikimin dhe parandalimin e faktorëve që prodhojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe kreator / agjentë të radikalizmit që mund të çojë drejt terrorizmit.”</i>
<i>“Ekstremizmi i dhunshëm dhe dukuria devijuese që nënkupton përgatitje, mobilizim dhe rekrutim të individëve dhe grupeve për veprim të dhunshëm propagandues ë udhëzuar kah realizimi i qëllimeve ekstremiste dhe terroriste.”</i>
<i>“Kusht për aktivitet të kryer nga persona ose grupe personash me pikëpamje radikale, veprime ekstremiste me angazhimin e grupeve të synuara ose individë për jo tolerancë ndaj grupeve etnike, racore ose fetare dhe stimulimin ose nxitjen e dhunës dhe ekstremizmit.”</i>

Duke i hulumtuar veglat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit arrijmë deri te qëllimi i përgjithshëm strategjik për PEDh dhe LKT të Republikës së Maqedonisë.

### **Qëllimi i përgjithshëm strategjik i Republikës së Maqedonisë për PEDh dhe LKT:**


<sup>4</sup> Për shembull, disa forma të radikalizmit në të vërtetë mund të jenë një forcë për një ndryshim të dobishëm. Për shembull, njerëzit që mbështetën heqjen e skllavërisë ose që përfaqësonin të drejtën universale për të votuar u konsideruan radikal në atë kohë, sepse ata ishin kundër pikëpamjeve dominuese të shoqërive të tyre. Burimi: “Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach,” Botuar nga OSBE, Vjenë , shkurt 2014

PARANDALO: por nëse, kur dhe ku parandalimi nuk ka sukses, NDIQ ( në mënyrë të rregulluar, pengoi, degradoi, shkatërroi dhe mposhti) kërcënimet terroriste, aleatët e tyre dhe strehimoret e tyre të sigurta në kuadër të territorit të Republikës së Maqedonisë, .... njëkohësisht dhe çdo herë duke respektuar gatishmërinë për të MBROJTUR dhe tu PËRGJIGJUR kërcënimeve ndaj qytetarëve dhe infrastrukturës kritike të Republikës së Maqedonisë.

## METODOLOGJIA PËR STRATEGJITË KOMBËTARE PËR PEDH DHE LKT


- Metodologjia për Strategjitë kombëtare për PEDh dhe LKT respekton qasje të vetme, por të fuqishme që: Fokusohet tek *Qytetarët e Republikës së Maqedonisë* si mision kolektiv dhe i përgjithshëm,
- Të dërgon drejt ndërtimit të Strategjive kombëtare gjithëpërfshirëse për implementim ( Qëllime – Mënyra – Mjete) bazuar mbi një set të përbashkët të parimeve udhëzuese për PEDh dhe LKT
- Identifikon të ashtu quajtura “Efekte transformuese”... të cilat i paraqesin mënyrat në të cilat KKPEDhLKT mund të ndihmojë në dhënien e rekomandimeve për riorganizimin e përpyekjeve institucionale dhe të komunitetit në përballjen me sfidat dhe mundësitë.

**FIGURA 6. Metodologjia për qasje strategjike të Maqedonisë drejt organizimit për PEDh dhe LKT**



Metodologjia jonë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit fillon dhe përfundon me fokusin e Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj, dhe njëkohësisht duke pasur parasysh përpjekjet dhe interesat e vendeve fqinje dhe partnerëve të komunitetit ndërkombëtar.

**FIGURA 7. Qasje strategjike drejt parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit**



6

Roli esencjal dhe përgjegjësia e KKPEDhLKT është të sigurojë koordinim dhe planifikim kooperativ dhe veprime të nevojshme për parandalim, mbrojtje, ndjekje dhe përgjigje ndaj kërcënimeve nga radikalizmi të cilat mund të rezultojnë deri në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm.



## TERMINOLOGJIA (FJALORTH PËRSHKRIMI I TERMEVE)

### PËRSHKRIMI I TERMEVE KRYESORE\*<sup>5</sup>

<b>Plani i veprimit</b>	Një sekuencë hapash që duhet të ndërmerren ose aktivitete që duhet të zhvillohen mirë, që një strategji të ketë sukses. Një plan veprimi ka tre elemente kryesore (1) Detyra specifike: çfarë do të bëhet dhe nga kush? (2) Horizonti kohor: kur do të zhvillohet. (3) Shpërndarja e resurseve: çfarë fonde specifike janë në dispozicion për aktivitete specifike.
<b>Kategori të njerëzve në rrezik</b>	Personat që janë në veçanti të cenuar për t'u bërë të radikalizuar në ekstremizëm të dhunshëm. Një numër i faktorëve mund të bëjë njerëzit të cenueshëm ndaj radikalizmit, përfshirë edhe shkëputja nga familja, miqtë ose komunitetin më të gjerë dhe ekspozim në krim ose dhunë.
<b>Komuniteti</b>	Një hapësirë që i përket, e përbërë nga domethënie të përbashkëta, e përbërë nga një ose më tepër lidhjeve të kombinuara gjeografike, imagjinare, emocionale, politike dhe tjera.
<b>Organizata e bazuar në komunitet</b>	Një organizatë e udhëhequr nga banorët e komunitetit në gjitha aspektet e ekzistencës, që do të thotë se shumica e trupit administrativ dhe stafit përbëhet nga banorët lokal; fushat e çështjeve prioritare janë të identifikuar dhe përcaktuar nga banorët; zgjedhjet për trajtim të çështjeve prioritare zhvillohen nga banorët; dizajni i programit, zbatimi dhe komponentët e vlerësimit i përfshin banorët në mënyrë të afërt në pozita udhëheqëse
<b>Policia në komunitet</b>	Policia në komunitet është një filozofi që promovon strategji organizative, që mbështetin përdorimin sistematik të partneritetit dhe teknikave për zgjedhje të problemit, në mënyrë pro aktive të trajtojë kushtet e menjëhershme që japin vëmendjeve çështjeve të sigurisë publike siç janë krimi, prishja e rendit social dhe frika nga krimi.
<b>Rezistenca e komunitetit</b>	Masa e aftësisë së qëndrueshme të një komuniteti për të përdorur resurset në dispozicion për të kundërshtuar dhe rikthyer nga situatat negative.
<b>Kundër narrativi</b>	Veprime që në mënyrë të drejtpërdrejtë të shkatërrojnë, zhvlerësojnë dhe zbardhin mesazhet e ekstremizmit të dhunshëm.

<sup>5</sup> Lista „Përshkrime“, terme referente do të vazhdojë të evaluohet. Me rëndësi të njëjtë, kjo listë e evaluar e termeve do të përmbajë braspeshë të përshkrimeve “sociologjike”, me qëllim të jetë lehtë dhe qartë e qasshme dhe e kuptueshme për publikun më të gjerë, dhe njëkohësisht termet janë „ligjore“ konsekuente dhe të vlefshme në pajtim me të drejtën dhe tekstet juridike dhe praktikant e zakonshme të Republikës së Maqedonisë dhe të komunitetit ndërkombëtar.

## VIZIONI DHE MISIONI I PEDH DHE LKT

SWOT analiza e detajuar rezultoi me kuptimin e thellë, të gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe pranimin e sfidave, shkaqeve rrënjësore, dhe mundësitë potenciale që e përkufizojnë mandatin e KKPEDhLKT në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Republika e Maqedonisë dhe vendet e Ballkanit në mënyrë kolektive janë të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve që rezultojnë nga radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi, në veçanti të përkeqësuar nga dukuria e luftëtarëve të huaj terrorist.

Duke e analizuar mjedisin e rreziqeve me kontekst më të gjerë dhe duke i pasur parasysh kërcënimet me të cilat përballlet Republika e Maqedonisë në nivel shtetëror, lokal (komunal), rajonal dhe ndërkombëtar, vizioni dhe misioni jonë janë:

### VIZIONI

*Të sigurohet Republika e Maqedonisë e sigurt dhe sovrane e cila është përfshirëse, ju del në ndihmë nevojave të qytetarëve të saj, dhe është e integruar në rajon dhe më gjerë.*

*Kërcënimi terrorist nuk mund ti prekë më qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Infrastruktura kritike dhe kufijtë janë të qëndrueshme dhe të sigurt. Organizatave terroriste u është reduktuar strehimi i sigurt dhe liria e lëvizjes dhe veprimit.*

### MISIONI i përgjithshëm për PEDh dhe LKT të Republikës së Maqedonisë :

**Të zhvillohen kapacitete dhe aktivitete qeveritare dhe shoqërore efikase, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse për parandalim, mbrojtje, ndjekje dhe përgjigje ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që mund të rezultojë me terrorizëm, në pajtim me vlerat e shtetit, me qëllim të mundësohet / promovohet shtet i sigurt dhe me prosperitet.**

Nëpërmjet këtij misioni të përgjithshëm, Republika e Maqedonisë përkushtohet në përmirësimin e përgatitjes për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit me sigurim (për shtetin dhe qytetarët) e kapaciteteve qeveritare dhe shoqërore gjithëpërfshirëse dhe aftësi për parandalimin e tyre. Këto kapacitete dhe aftësi do të jenë efikase dhe llogaridhënëse para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ndërsa në pajtim me rregullat dhe vlerat kushtetuese, ligjore dhe procedurale.

Nga kjo Deklaratë për misionin, rezulton misioni specifik për luftë kundër terrorizmit.

### **MISIONI specifik i Republikës së Maqedonisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm**

*Të sigurojë dhe promovojë shtet të sigurt dhe me prosperitet nëpërmjet aktiviteteve të koordinuara, të cilat parandalojnë, mbrojnë, realizojnë dhe i përgjigjen identifikimit dhe zbulimit të hershëm të faktorëve të cilët kontribuojnë për radikalizëm, ekstremizëm dhe aktivitete të dhunshme në formë të terrorizmit dhe/ose aktiviteteve terroriste.*

## ANALIZA STRATEGJIKE E RRETHINËS

Republika e Maqedonisë, si edhe shumë vende të tjera të komunitetit ndërkombëtar, nuk është immune ndaj kërcënimeve nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi. Kohën e fundit, kërcënimi global kërkon Republika e Maqedonisë ti rishqyrtojë raportet me fqinjët e saj, komunitetin ndërkombëtar, si dhe me aktorët e vendit, kur bëhet fjalë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Ekstremizmi radikal i cili çon drejt dhunës dhe mund të rezultojë me terrorizëm në mënyrë ciklike dhe të drejtpërdrejtë i *godet themelet e individit, familjes, komunitetit dhe shtetit.*

Rritja e tensioneve ndërkombëtare që ka ndodhur së bashku me ndarjet rajonale të vendeve të Ballkanit, të nxitura nga flukset e mbështetjes financiare nga burime të huaja, ka inkurajuar komunitetet që të bëhen më radikale dhe ekstreme. Shqetësim të veçantë paraqesin rastet e luftëtarëve të huaj terrorist. Sipas informatave për vitin 2016, 110 luftëtarë nga Republika e Maqedonisë kanë shkuar në Siri, prej të cilëve 25 janë vrarë në Siri, ndërsa 86 janë kthyer në shtëpi<sup>6</sup>.

KKPEDhLKT ka obligim të vlerësojë faktorët e rrezikut dhe kushtet në rrethinën që mund të kontribuojnë deri në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm si fenomene universale.

### Niveli shtetëror

Kapacitetet e kufizuara të institucioneve shtetërore janë pengesë në zbatimin efikas kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. KKPEDhLKT e analizon nevojën se institucionet shtetërore duhet të mbindërtohen dhe të punojnë në mënyrë kooperative për të kuptuar rëndësinë e PEDh dhe LKT, si dhe aktivitetet specifike të cilat institucionet duhet ti realizojnë për të siguruar shtet të qëndrueshëm dhe sovran.

KKPEDhLKT i përkushtohet rëndësisë së ankesave reale dhe të perceptuara të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, siç janë për shembull marginalizimi i komuniteteve, jo toleranca për dallimet kulturore, religjioni dhe gjuhët, dhe praktika jo adekuate ose të pa drejta të organeve të ndjekjes. Sjellja negative që lidhet me këto ankesa mund të ndryshohet pozitivisht nëse të gjitha institucionet qeveritare qartë dhe me përgjegjësi ti përfaqësojnë të gjithë qytetarët. Në këtë mënyrë shteti do të miratojë qëndrime proaktive për mbrojtje nëpërmjet parandalimit nga mos respektimi i të drejtave të qytetarëve të saj. Sundimi i mirë promovon shoqëri civile të fuqishme.

Me rëndësi imperative është Republika e Maqedonisë të vazhdojë të përmirësojë standardizimin e përgjigjes së saj institucionale ndaj PEDh dhe LKT. Përpjekjet institucionale për krijimin e trajnimit gjithëpërfshirës dhe mbështetje në krijimin e platformave dhe baza të informata për ndarjen e të dhënave të përbashkëta informata të agjencive dhe informata të kundërzbulimit, dhe rritjen e besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve qeveritare të sigurisë dhe liderët e komuniteteve do të sigurojnë konsistencë të përpjekjeve.

<sup>6</sup> Analytica dhe Ambasada e SHBA-ve, "Assessment of Macedonia's Efforts in Countering Violent Extremism, View from Civil Society," qershor 2016.

## **Niveli komunal / lokal**

KKPEDhLKT fokusohet në çështje të ndryshme në nivel lokal të pushtetit, duke sugjeruar disa fusha ku qeveritarët shtetëror dhe lokal dhe institucionet duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që të parandalojnë dukuritë e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Në këto bëjnë pjesë:

- Përmirësimi i besimit dhe bashkëpunimi ndërmjet shërbimet qeveritare të sigurisë dhe udhëheqësit fetar,
- Saktësimi plotësues i trajnimit gjithëpërfshirës që komunitetet fetare ti kundërvihen on line radikalizmit,
- Avancimi trajnimit në komunitet, në familjet, personelin e burgjeve dhe udhëheqësit fetar, me qëllim të identifikohen shenjat e hershme të radikalizmit të dhunshëm:
- Zhvillimi i mjeteve dhe masave për kundërshtimin e vëllimit të dezinformative që rrjedhin nga narrativë të politizuar tek kategoritë e cenueshme (rrezikuara) të qytetarëve dhe
- Krijimi i proceseve dhe procedurave për inkurajimin e programeve në komunitet për mbështetjen e kohezionit shoqëror, që e parandalon ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Papunësia dhe përgjigjja jo përkatëse e organeve policore e plotësojnë frustrimin e komuniteteve të cilat besojnë se nevojat e tyre nuk kuptohen seriozisht. Dështimi, ose përgjigjja latente e thirrjeve të komunitetit për ndihmë nga institucionet shtetërore në mbrojtje të qytetarëve, e përforcon dukurinë e aktiviteteve të dhunshme dhe radikale.


Në Republikën e Maqedonisë, tendenca të inkurajohen qytetarët të mbajnë shoqëri etnike dhe konfidenciale të mbyllura, në vend të përpjekjeve të inkurajohet integrim inkluziv, inter - intra - kulturor dhe tolerancë fetare, të cilat në masë të madhe janë shkaqe të rëndësishme për trazira. Më pas, këto dallime në shoqëri kontribuojnë drejt dëshirës individuale ose kolektive të pranohet ekstremizmi. Në rast të fundit, ndarja dhe përjashtimi në mënyrë të konsiderueshme do të kontribuojnë drejt efekteve trans nacionale të bartjes, që i përforcojnë pasojat në nivel lokal, shtetëror dhe rajonal.

## **Niveli rajonal**

Republika e Maqedonisë gjendet në një udhëkryq të lëvizjeve trans nacionale që lidhin grupet kriminale, ideologjike dhe ekstremiste, zgjerimin, ndikimin dhe aktivitetet e të cilave shteti mund ti ndalojë ose së paku të pengojë me ndihmën dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Republika e Maqedonisë ka promotor të shumtë kryesor ose faktor të cilët nuk janë specifik për shtetin. Pikëpamja gjithëpërfshirëse e asaj se si përputhen këto nivele mund të shihet në Figurën 8.

**FIGURA 8. Disa promotorë kryesorë dhe faktorë për ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm**



**Tabela 2a 2018 SWOT ANALIZA**

	<b>PËRPARËSI</b>	<b>MANGËSI</b>
<b>NIVELI RAJONAL</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pozita kyçe gjeostrategjike – R. e Maqedonisë është “Shtet i rendesishëm strategjik”</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë gjendet në rajon turbulent dhe mesatarisht jo stabil në shtete relativisht të dobëta demokratike</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë nuk është “shtet në konflikt”</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë është e rrethuar me shtete post konfliktuozë dhe me ekonomi jo stabile , politika të trashëguara që ndikojnë mbi cilësinë e ndërtimit të sistemeve të qëndrueshme shoqërore,</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>R e Maqedonisë nuk është eksportues i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Reduktimi drastik i luftëtarëve të huaj terrorist nga viti 2015 e këndej</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë është e shtrirë në udhëkryq gjeostrategjik Lindje – Perëndim e rrethuar me vende me kufij të cenueshëm të cilat nxisin “ekonomi informale”</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>Nivel i pamjaftueshëm i ndarjes së informatave rajonale financiare dhe anti terroriste kundër zbuluese</li> </ul>
<b>NIVELI SHETETËROR</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë është shtet me institucione qeveritare të vendosura mirë dhe sisteme dhe procedura për sundimin e së drejtës</li> <li>R. e Maqedonisë është e harmonizuar me shumë shtylla kryesore të KB-së, BE-së, OSBE-së dhe NATO-s</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë ende përballlet me shkallë relativisht të lartë të pakënaqësisë dhe mos pasjes së besimit ndërmjet komuniteteve me qeveritarët shtetëror dhe lokal</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>Kapacitetet e pa mjaftueshme shtetërore dhe komunale dhe aftësitë e institucioneve qeveritare dhe sfidat e vazhdueshme me korrupsionin</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>R e Maqedonisë ka lidhje të fuqishme pozitive me organizata ndërkombëtare, të përkushtuara në misionin global të parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër terrorizmit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra të pamjaftueshme dhe masa për kundërshtimin e vëllimit të dezinformatave që i zbulojnë narrativët e polarizuar ndërmjet publikut të cenueshëm</li> </ul>
<b>NIVELI KOMUNAL / LOKAL</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë është shoqëri e cila karakterizohet me familje të fuqishme, lidhje familjare dhe komunitete të fuqishme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punësimi i pamjaftueshëm, në veçanti te komunitetet rinore</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në R. e Maqedonisë ekziston tendencë për dallime etnike dhe fetare dhe diversitete</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lidhje të dobëta të besimit ndërmjet policisë lokale / organet e ndjekjes dhe popullatës lokale</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë tradicionalisht kultivon formë mesatare të religjionit islam dhe krishterimit ortodoks, që nuk identifikohet me degë radikale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mos ekzistimi i mangësive të organeve “legjitime” krijon vakum lidershipi, të cilën lehtë e plotësojnë liderët e ekstremistëve radikal me vizione dhe qëllime të fuqishme anti shtetërore dhe anti nacioanle</li> </ul>

**Tabela 2b 2018 SWOT ANALIZA**

	<b>MUNDËSI</b>	<b>KËRCËNIME</b>
<b>NIVELI RAJONAL</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i grupeve shtetërore për veprime të fokusuara, multi agjencionale, ndërinstucionale për përcaktimin e strategjive rajonale të Ballkanit Perëndimor për PEDh dhe LKT të udhëhequra nga R e Maqedonisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për shkak të pozitës gjeostrategjike, R. e Maqedonisë çdo herë është nën rrezik nga sulme terroriste //</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Bashkëpunim efikas i BE-së, OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve, ekspertizë dhe mjete nga donatorë</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>“Nyja” trans nacionale dhe trans rajonale e plotësojnë kërcënimin nga krimi me tregtinë joligjore, korrupsionin dhe terrorizmin.</b></li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Standardizim i përmirësuar në mbarë platformat rajonale për shpërndarjen e të dhënave, përfshirë edhe përpunimin e të dhënave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrjedhat e luftëtarëve të huaj terrorist dhe ndikimet nga vendet që gjenerojnë konflikt</li> </ul>
<b>NIVELI SHTETËROR</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i përforcimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve institucionale të KKPEDhLKT</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra në të cilën shteti i përgjigjet kërcënimeve nga radikalizmi, ekstremizmi i dhunshëm, dhe terrorizmi, duhet të jetë i vëmendshëm dhe i kujdesshëm që të mos shkaktojë efekt negativ “bumerang”</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i grupeve të punës të integruara (Integrated Task Forces (ITFs)) për zbatimin e aktiviteteve të koordinuara, ndërinstucionale ndërmjet shtetit dhe komunitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ekstremizëm dhe radikalizëm etno – religjioz dhe ideologjik</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i Grupeve të përhershme shtetërore të punës për koordinimin dhe vlerësimin e aktiviteteve për PEDh dhe LKT për çdo prioritet strategjik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konkurrencë për resurset e kufizuara të qasshme për mbështetje të komuniteteve, mos pasjen e përpjekjeve të unifikuara, për shkak të mungesës së kapaciteteve qeveritare</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i Grupeve Speciale të Integruara (Integrated Task Forces (ITFs)), përfshirë edhe grupin e punës operativ për luftë kundër terrorizmit (Joint terrorism Task Force (MKD-JTTF)) për kontrollin e përmirësuar të fushës kufitare dhe veprimit gjatë krizave, parandalim dhe përgjigje</li> </ul>	
<b>NIVELI KOMUNAL / LOKAL</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Themelimi i Ekipeve të veprimit në komunitet (Community Action Teams (CATs)) për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet qeveritarëve shtetëror dhe lokal</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Masat e ndërmarra me qëllim të parandalohet ekstremizmi dhe radikalizmi mund të cenojnë liritë dhe të drejtat personale</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>R. e Maqedonisë karakterizohet me popullatë rinore të fuqishme, të shëndetshme dhe të talentuar e cila krijon dhe kultivon - tolerancë ndër fetare dhe ndër etnike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Struktura e të papunësuarve dhe punësimi i pamjaftueshëm</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Saktësimi plotësues i trajnimit gjithëpërfshirës që komunitetet fetare ti kundërvihen on line radikalizmit,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Padrejtësi dhe ndjenjë të pakënaqësisë të komuniteteve lokale, dhe mos pasja e besimit ndërmjet popullatës lokale, familjes dhe komunitetit me përfaqësuesit e shtetit dhe komunës</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim i përmirësuar për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit të dhunshëm, përfshirë edhe personelin në burgje dhe personelin tjetër profesional</li> </ul>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i mënyrave për inkurajimin e programeve në komunitet për mbështetjen e kohezionit shoqëror, që e parandalon ekstremizmin e dhunshëm.</li> </ul>	



## **PËRPIJËKJET E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR TË LUFTUAR EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM<sup>7</sup>**

Në fushën e sigurisë ndërkombëtare, shoqëritë përballen me diçka që duket si eksplozion i terrorizmit për shkak të ekspansionit ekstremist të aktorëve jo shtetëror. Ekzistojnë shumë teori rreth shkaqeve për këtë. Zbulimi dhe studimi i marginalizimit, përjashtimit, represionit dhe disavantazheve të tjera sociale dhe ekonomike kanë për qëllim gjetjen e mënyrës më të mirë për të luftuar ekstremizmin<sup>8</sup>.

Në vitin 2011, administrata e SHBA-së njoftoi strategjinë e saj kundër terrorizmit, duke përcaktuar luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (PEDh) si një nga gjërat më të rëndësishme, duke inkurajuar komunitetin ndërkombëtar që të bëjë përpjekje më të mëdha për përfshirjen PEDh në përpjekjet e tyre kolektive dhe politikat e brendshme. Më pas, procedurat e administratës së SHBA-së rezultuan me themelimin e Hadayah, think – tank i parë, i cili u fokusua vetëm në parandalimin ose luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Konferenca e parë e Hadayah përfshinte 25 kombe që u pajtuan se PEDh duhet të jetë prioritet në çdo politikë të ardhshme nacionale të sigurisë. Vende si Australia kanë akorduar 47 milionë dollarë për të mbështetur grupet e drejtorëve, psikologëve dhe shërbimeve studentore për të ndihmuar shkollat të zhvillojnë strategji që të identifikojnë studentët në rrezik nga radikalizmi dhe të mbështesin politikën e tyre të PEDh.

Ekstremizmi i dhunshëm i cili identifikohet me terrorizmin, ka histori më të gjatë. Sot, globalizimi dhe ndërlidhjet midis kombeve e kanë vënë PEDh në fokusin e vëmendjes, duke i detyruar qeveritë të përqendrohen në këtë fenomen dhe të përcaktojnë se si ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të gjitha nivelet e sigurisë ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale. Ekstremizmi i dhunshëm i kalon kufijtë shtetëror dhe kontinentet, dhe ngjarjet e 11 shtatorit të vitit 2001 tregojnë se dhuna është bërë normë në këto grupe, shpesh për asnjë arsye të dukshme, përveç armiqësisë ndaj vlerave perëndimore. Ekstremistët e dhunshëm e ngritën luftën e tyre në një nivel më të lartë, duke shfrytëzuar mediat sociale, tregjet e zeza dhe hapjen e shteteve për udhëtim dhe këmbim të mallrave dhe shërbimeve Tani është thelbësore të kuptojmë filozofinë e ekstremistëve të dhunshëm dhe nevojën për t'u përgjigjur çështjeve që janë bazë për këto fenomene.

Ekstremizmi i dhunshëm në Irak dhe Siri ka shkatërruar komunitete të mëdha etnike dhe fetare dhe shkatërron gjithashtu strukturat shoqërore dhe politike të këtyre vendeve. Efekti i saj është krijimi i katastrofës më të madhe humanitare në historinë e kohëve të fundit - kriza e refugjatëve. "Shteti Islamik" terrorist ka shpërngulur miliona njerëz dhe është përfshirë në mizori masive brutale bazuar në konceptin e tmerrshëm të ideologjisë. Në Ballkan, mjedisi aktual, duke përfshirë fluksin e refugjatëve dhe luftëtarëve të huaj - të kthyerit, bën që vëmendja ndaj PEDh të jetë me rëndësi esenciale, aq më tepër nëse duam paqe dhe stabilitet në rajon. Edhe pse Republika e Maqedonisë për momentin nuk është shtet në konflikt, intervenimi aktiv nëpërmjet planifikimit dhe analizimit të kujdesshëm të ekstremizmit të dhunshëm është më tepër se e detyrueshme,<sup>9</sup>

## **ANALIZË E SITUATËS DHE SHTRIRJA E PROBLEMIT**

Republika e Maqedonisë nga gushti i vitit 2017 ka formuar Komitetin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit (KKPEDhLKT), i cili i koordinon kapacitetet (institucionale) (jo) shtetërore në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit. KKPEDhLKT menjëherë filloi të avancojë bashkëpunimin ndërinstitucional për të luftuar dhe parandaluar ekstremizmin e dhunshëm në pajtim me

<sup>7</sup> Burimi: U.S. Department of State, "Bureau of Counterterrorism and countering Violent Extremism, Country Reports on Terrorism 2016, accessible (online) at <https://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2016/272231.htm#Macedonia>

<sup>8</sup> DeGennaro, Patricia, US Government White Paper on CVE, 2016.

<sup>9</sup> Source: U.S. Department of State, "Bureau of Counterterrorism and countering Violent Extremism, Country Reports on Terrorism 2016, accessible (online) at <https://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2016/272231.htm#Macedonia>

rekomandimet e Bashkimit Evropian, SHBA-ve, dhe Plan veprimin për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të Sekretariatit të Përgjithshëm të KB-së.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka iniciuar përgatitjen e një studimi zyrtar mbi promotorët e ekstremizmit të dhunshëm në Republikën e Maqedonisë. Me mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë, KKPEDhLKT është në proces të grumbullimit të të dhënave dhe prezantimin e Plan Veprimin në mungesë të hulumtimeve të thella empirike. Organizata joqeveritare „Analytica“, si think – tank subjekt lokal, në tetor 2016 e publikoi raportin e financuar nga SHBA-të, me titull "Vlerësim i përpjekjeve të Republikës së Maqedonisë në luftën me ekstremizmin e dhunshëm". Në bazë të analizës fillestare, promotorët e ekstremizmit në Republikën e Maqedonisë përfshijnë faktorë të ngjashëm, si ato që janë promotorë të ekstremizmit global, ndonëse në një farë mënyre të plotësuar me marginalizimin real dhe të perceptuar të popullatës etnike shqiptare dhe pikëpamjet e rritjes së tensioneve në kuadër të bashkësive fetare. Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë ka nisur një nismë për trajnimin për përballje me ekstremizmin e dhunshëm për imamët, me qëllim që të inkurajojë komunitetin që të gjejë alternativa në vend të pranimit të dhunës.

Në nëntor 2017, në Shkup, komuniteti ndërkombëtar mbajti takim gjatë të cilit u diskutua për vlerësimet dhe programet e PEDh. Në shkurt 2018, në Ohër u mbajt punëtori njëditore për planifikim strategjik, në të cilën morën pjesë shumica e anëtarëve të KKPEDhLKT dhe ekspertë tematik për PEDh dhe LKT nga më shumë institucione të Republikës së Maqedonisë dhe rajoni. Vijoi edhe punëtori plotësuese në Shkup e cila i përcaktoi kornizat e dokumenteve Strategjike për PEDH dhe LKT dhe Planet e veprimit.

## **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL**

Republika e Maqedonisë është partner i përkushtuar / i suksesshëm në luftën kundër terrorizmit, në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Republika e Maqedonisë në masë gjithnjë e më të madhe i përdor përparësitë e kornizës së vendosur të bashkëpunimit në lidhje me luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit me partnerët e saj nga rajoni, në veçanti me Shqipërinë, Kosovën dhe Bosnjë dhe Hercegovinën.

Republika e Maqedonisë, gjithashtu si anëtare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ishte nikoqire e seminarit të zhvilluar nga OSBE në shtator 2017, duke bashkuar gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit nga rajoni për të forcuar aftësitë kombëtare dhe kapacitetet dhe të përmirësojnë përgjigjet ndër-rajonale në trajtimin e terrorizmit.

Në nëntor të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ishte bashkë organizuese e një stërvitjeje ushtarake ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin, krijoi një mënyrë koordinimi, bashkëpunimi dhe shkëmbimi të informacioneve për Qeverinë si tërësi (whole-of-government), si dhe model të integruar planifikimi për luftën kundër terrorizmit dhe PEDh.

Në shkurt, 2018, KKPEDhLKT, të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, mbajtën konsultime publike me aktorët e shoqërisë civile, me qëllim inkorporonim e rekomandimeve të tyre me dokumentet e reja strategjike.

## TË KUPTUARIT E KËRCËNIMIT DHE RRETHIMI I TIJ <sup>10</sup>

Të kuptuarit e kërcënimeve ndihmojnë të kuptojmë fuqitë tona, rolet dhe përgjegjësitë dhe prioritetet aktuale-të afërta-afatgjate – më së paku të tre konteksteve të ndërlidhura: nivelin shtetëror, nivelin lokal (dhe komunal) dhe nivelin rajonal/ndërkombëtar.

**GLOBAL**, marrëdhëniet ndërkombëtare kalojnë nëpërmjet tranzicionit të madh të fuqisë dhe konkurrencës politike ndërmjet shteteve që krijojnë parakushte për dukuri të organizatave të dhunshme ekstremiste dhe grupeve terroriste të cilat i kërcënohen rendit të vendosur botëror.

Kjo periudhë e ndryshimeve karakterizohet me numër të madh të sfidave dhe sfidues të *normave dhe parimeve qeverisëse, rregulla dhe procedura për miratimin e vendimeve*<sup>11</sup> që i kanë përkufizuar kushtet për sigurimin e bazës së qëndrueshme të rendit ndërkombëtar perëndimor - liberal ("Uestfalijan") - respektivisht:

1. Supremacioni i sovranitetit territorial të shtetit,
2. Rregulli i përgjithshëm i pa cenueshmërisë së sovranitetit territorial të shtetit.
3. dhe Përkufizimi për "agresion" si akt të shtetit ose kolektiv të shteteve që e cenon dhe shkelin integritetin territorial dhe pushtetin e shtetit kombëtar, ndërsa
4. i deklaruar si "mëkat" i skajshëm ndërkombëtar, akti kërkon intervenime sigurie kolektive që përsëri të vendoset *status quo* situata.

Stabilitet sistemor, në bazë të këtyre katër parimeve sunduese, është "lëkundur" në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar me kërkesa të rinovuara për vetë përcaktim dhe rritjen e konflikteve etno – separatiste gjatë viteve të nëntëdhjeta. Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, e paralajmëruan, rritjen e aktorëve të tjerë jo shtetërorë, në veçanti Al Kaeda dhe degët e saj, përfshirë edhe degët e saj, përfshirë edhe të a.q. shtet Islamik.

**RAJONAL**, shohim prezencë në rritje të kërcënimeve dhe sfidave trans rajonale dhe të përziara që i tejkalojnë kufijtë, kryejnë presion të madh mbi vendet dhe aftësitë e tyre dhe kapacitetet të ruajnë sovranitetin e tyre, ti mbrojnë të drejtat private dhe vlerat kryesore të sistemeve. Në kuadër të këtyre karakteristikave gjeo – strategjike gjendet edhe Republika e Maqedonisë e përballur me kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Republika e Maqedonisë dhe vendet e Ballkanit janë shtete kryesore<sup>12</sup> "strumbullar strategjik" prej të cilave pjesërisht varet e ardhmja stabile dhe siguria e Bashkimit Evropian, koherenca e krahut jugor të NATO-s.

---

<sup>10</sup> Wilson III, Isaiah. "Power in Transition: Challenges of Providing for an uncommon defense and the search for strategic stability," presentation for RAND Corporation, February 2017.

<sup>11</sup> See Stephen Krasner, *International Regimes* (1986).

<sup>12</sup> "Why are Pivot States so Pivotal? The role of pivot states in regional and global security, *The Hague Centre for Strategic Studies*, 2014.

**FIGURA 9.** Të kuptuarit e mjedisit “të përzier” trans rajonal të kërcënimeve



Fakti që Republika e Maqedonisë nuk është eksportuese e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit është një nga avantazhet më të mëdha të saj; arsyetimi më i fortë për aderim drejt integritimeve euro-atlantike, e cila e bën partner të aftë dhe të pozicionuar mirë në aspektin gjeopolitik, me mundësinë për të forcuar stabilitetin dhe sigurinë e BE-së.

Republika e Maqedonisë është shtet i rëndësishëm strategjik për të kundërshtuar shkaqet dhe parakushtet kryesore që ushqejnë dhe përhapin kërcënimet e radikalizmit që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm dhe në fund edhe në terrorizëm.

Sfida më shqetësuese e këtyre kërcënimeve të përziera është ndikimi i tyre negativ në kapacitetin e strukturave institucionale, kulturave organizative dhe praktikave funksionale. Në këto kërcënime bëjnë pjesë:

- Punësimi i dobët dhe papunësia,
- Padrejtësia e perceptuar dhe reale,
- Diskriminimi dhe marginalizimi,
- Mos pasja e kapaciteteve institucionale, urban dhe rural që, nga njëra anë i ushqen keqkuptimet në lidhje me atë se shteti me qëllim mbështet grupe specifike ( shumicën),
- Probleme institucionale: koordinim i dobët ndërmjet institucioneve shtetërore; mungesa e mekanizmave për përcaktimin e bartësve dhe pozicioneve të subjekteve në institucione,

mungesa e besimit të ndërsjellë, nevoja e reformës së politikave të institucioneve, mungesa e një imazhi të përbashkët sa i përket kërcënimeve të mundshme; dhe

- Mungesa e proceseve që mundësojnë ndërtimin e besimit në nivel lokal, në baza të rregullta; rritja e prezencës së forcave policore në komunitetin lokal, që do të mundësojë udhëheqjes komunale dhe shtetërore të kenë një pasqyrë të përbashkët të problemeve reale.

Në **NIVEL SHTETËROR dhe KOMUNAL - LOKAL**, marrëdhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë ndërmjet komuniteteve vazhdojnë të jenë relativisht të tensionuara herë pas here, veçanërisht në pjesë të vendit ku grupet aktive ekstremiste janë ende të pranishme, të prirë për përdorim të dhunës për të arritur qëllimet e tyre politike. Deri tani, ka pasur raste individuale të dhunës ndaj qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Maqedonisë, të cilat mund të intensifikojnë reagime të dhunshme.

Gjithashtu, prioritet është mbrojtja e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë nga ndikimi i ideologjive ekstremiste të bazuara në intolerancë, urrejtje dhe dhunë me qëllim arritjen e synimeve politike dhe ideologjike, duke përfshirë keqinterpretimin e feve.

Në të njëjtën kohë, jemi dëshmitarë se kjo reflekton negativisht në marrëdhëniet dhe sjelljet "në mëhallë dhe fqinjësi" që mbështeten tek besimi, jo vetëm në kontekstin lokal, por edhe në një kontekst rajonal.

Me këto lloje të reja dhe në rritje të sfidave dhe kushteve, gatishmëria dhe parandalimi bëhen kritike dhe parakushte esenciale për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e kapaciteteve efikase, legjitime, qëndrimin dhe profilin për luftën ndaj terrorizmit.

Me këtë, sfida për Republikën e Maqedonisë, dhe aq më konkretisht për Komitetin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit (KKPEDhLKT) do të jetë sa është e mundur më herët të identifikohen ato kërcënime në "hapësirat jo të rregullta" në dhe ndërmjet niveleve të pushtetit komunal dhe shtetëror, si dhe në dhe ndërmjet niveleve të partneritetit rajonal dhe trans - rajonal me BE-në, KB-në, NATO-n, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

## **EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE SHKAQET E TIJ RRËNJËSORE**

Ajo që e bën ekstremizmin e dhunshëm një rrezik të veçantë për Republikën e Maqedonisë është mjedisi global gjeopolitik, i plotësuar nga shkaqet dhe kushtet e rrënjësura si bazë për mbijetesën afatgjatë të këtyre kushteve, pa trajtim ose me trajtim të pamjaftueshëm. Pavarësisht gjendjes së stabilitetit etnik në shtetin jugosllav, anëtare e së cilës ishte Republika e Maqedonisë, pas shkatërrimit të saj, janë prodhuar çështje latente etnike dhe fetare që janë trajtuar në mënyrë të papërshtatshme. Shpallja e Republikës së Maqedonisë si shtet të pavarur, e imponoi tejkalimin e këtyre çështjeve nga e kaluara si nevojë të patjetërsueshme.

Këto besime ndëretnike dhe fetare plotësojnë gjendjen aktuale të menaxhimit me këtë natyrë jashtëzakonisht komplekse dhe shumë dimensionale të çështjes sot. Në mënyrë plotësuese, ndikimet ekstremiste nga entitete të tjera, nga fqinjësia dhe rajoni ndikojnë në udhëheqësi individuale separatiste dhe populiste që konkretisht fokusohen në shqiptarët etnik në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht, popullata jo shqiptare përballet me stimul populist nga ndikime të tjera fqinjësore / rajonale.

Kthimi nga format tani më të tejkaluara dhe karaktereve të gjendjes ndëretnike, prodhon dhe njëkohësisht ushqehet prej tyre, forma gjithnjë më virulente(helmuese) të hiper nacionalizmit, populizëm dhe shovinizëm, brenda në kuadër të shtetit, që bën politika rajonale e shteteve të jetë



gjithnjë e më e brishtë, paranoike dhe e ngarkuar me paragjykime dhe dallime kulturore /racore / fetare<sup>13</sup>.

Mjedisi aktual ndërkombëtar gjithashtu e bën më të vështirë ndërtimin e koalicioneve për sigurinë dhe mbrojtjen kolektive, njëkohësisht duke e bërë gjithnjë e më të nevojshme formimin e koalicioneve të tilla. Republika e Maqedonisë dhe vendndodhja e saj strategjike gjeopolitike dhe multietnike, bën vështirësi në konsolidimin e saj të brendshëm politik, dhe përkundër kësaj, kjo situatë kontribuon në krijimin e aleancave në baza të ndryshme me vendet fqinje. Tranzicione politike, përlëshjet mbi baza etnike, etno-separatizmi dhe kërcënimet terroriste globale që vazhdimisht përhapen dhe evoluohen, e bëjnë rajonin të jetë i ekspozuar ndaj ndikimeve negative. Megjithatë, iniciativa të miratohet Strategji Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm i mundëson Republikës së Maqedonisë potencialet e saj të drejtojnë kah zbutja e shkaqeve për të cilat qytetarët e saj do të ishin orientuar kah ekstremizmi i dhunshëm, duke shkaktuar jo stabilitet të brendshëm.

## **HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Në pajtim me Këshillin për Siguri të KB-së, Republika e Maqedonisë gjithnjë e më tepër e thekson nevojën për qasje gjithëpërfshirëse ndaj luftës nga përhapja e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Anëtarët e KKPEDhLKT organizuan punëtori me përfaqësues relevant të ministrive, në mënyrë që të përcaktojnë se si më mirë të reflektojnë në lidhje me PEDh në kontekst me angazhimet maqedonase për luftë kundër terrorizmit. Këshilli i Sigurimit i OKB-së thekson se PEDh është element thelbësor në përgjigjen ndaj kërcënimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, kërcënim që vjen nga ekstremizmi i dhunshëm dhe ndikimet e tij, duke përfshirë rekrutët dhe udhëheqësit lokalë, ata që vijnë nga luftërat të huaj terroriste që janë larguar jashtë shtetit që të luftojnë në vende të huaja, janë vendosur jashtë shtetit ose janë kthyer në Republikën e Maqedonisë dhe mund të ndikojnë tek bashkëqytetarë të tjerë.

Në pajtim me planet për PEDh të Këshillit të Sigurisë së OKB-së dhe Bashkimit Evropian, Republika e Maqedonisë është e përkushtuar në angazhimin e komuniteteve relevante lokale dhe aktorëve joqeveritar që të përpilojnë strategji për të luftuar narrativin e ekstremizmit të dhunshëm që mund të rrisin sundimin e së drejtës dhe të shkaktojë akt terroriste. Duke iu referuar kushteve që janë të përshtatshme për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, anëtarët e institucioneve të Republikës së Maqedonisë planifikojnë dhe zhvillojnë strategji, me përfshirjen në zbatimin e aktiviteteve të tyre të rinjtë, familjet, gratë, udhëheqësit fetarë, kulturorë dhe arsimorë dhe të gjitha grupet të tjera të interesuara të shoqërisë civile, në përpjekjet e përbashkëta për të zvogëluar ndikimin e këtyre kushteve<sup>14</sup>.

## **KONTEKST DHE PROMOTOR I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM<sup>15</sup>**

Nuk ekzistojnë të dhëna relevante statistikore për mënyrat e radikalizmit individual ( si në nivel global, ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë). Edhe pse ka disa trende dhe formula të identifikueshëm, hulumtimet kualitative ( të bazuara kryesisht mbi intervista) sugjerojnë se ekzistojnë "push faktorë" ose kushte që janë të përshtatshme dhe çojnë drejt ekstremizmit të dhunshëm dhe kontekstit strukturor nga i cili ai buron, dhe "pull faktorë" ose motivime personale dhe procese që luajnë rol kryesor në transformimin e ideve dhe veprimeve në akcione të dhunshme ekstremiste.

<sup>13</sup> Wilson, Isaiah, "Power in Transition: Challenges of providing for an uncommon defense и the search for strategic stability." Presentation for RAND Corporation, February 2017.

<sup>14</sup> See Countering Violent Extremism 20 February 2018, <https://www.un.org/sc/ctc/focus-areas/countering-violent-extremism/>. For the purposes of this strategy on CVE, NCCVECT coordinators и members recognize youth, families, women, religious, cultural и education leaders, и all other concerned groups to be inclusive within the 'civil society'.

<sup>15</sup> Kapitulli është modeluar në Plan veprimin për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm të OKB-së të datës 24 dhjetor 2015

**Tabela 3: Push faktorë dhe Pull faktorë të ekstremizmit të dhunshëm**

	Faktorë të cilët shtynjë (push)	Faktorë të cilët tërheqin (pull)
NIVELI RAJONAL	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet e jashtme, përfshirë edhe para nga të tjerë që jetojnë kryesisht në Gjirin e Arabisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arsimi në vende të cilat e promovojnë ekstremizmin</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pamundësia për përballje me grupet kriminele të cilat lehtë i kalojnë kufijtë, puna policore jo përkatëse në kategoritë e vunerabile (rrezikuara) ose zona rajonale të R. së Maqedonisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>RM-ja është e rrethuar me shtete të dobëta me stabilitet të brishtë post – konfliktuoz, politika të trashëguara të cilat ndikojnë mbi cilësinë e ndërtimit të sistemit shoqëror të qëndrueshëm, në veçanti të raporteve me vendet fqinje për përforsimin e harmonisë etno religjioze dhe unitetit kombëtar</li> </ul>
NIVELI SHTETËROR	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tendenca në mënyrë të pabazuar të akuzohen komunitetet etnike ose gupet religjioze</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>RM-ja vazhdon të luftojë për ndërtimin dhe kultivimin e identitetit të fuqishëm të unifikuar kombëtar</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Retorika e qeverisë, e cila e hedh fajin për ndodhitë e caktuara në shoqërinë ndaj grupeve të targtuara, në vend që të fokusohet në faktorët dhe treguesit e duhur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>RM- ja ende vuan nga shkalla relativisht e lartë e pakënaqësisë dhe mungesës së besimit ndërmjet komuniteteve, shtetit dhe pushtetit lokal</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka mision gjithëpërfshirës për parandalimin e të gjitha llojeve të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e kapaciteteve dhe aftësi institucionale të autoriteteve shtetërore dhe komunale, sfidat e vazhdueshme me korrupsionin</li> </ul>
NIVELI KOMUNAL DHE LOKAL	<ul style="list-style-type: none"> <li>Presion nga udhëheqësit fetar ( ndikim i brendshëm ose ndikim nga jashtë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Papunësia kronike dhe punësimi i pamjaftueshëm, sidomos në komunitetet pakicë etno-kulturore dhe fetare</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Margjinalizimi i grupeve etnike / religjioze</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Besim i dobët ndërmjet policisë lokale dhe autoriteteve lokale lidhur me sundimin e ligjit</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e mundësive, mohimi i shtetësisë ndaj grupeve të caktuara, pamundësia për tu integruar dhe të fitojnë mbrojtje dhe shërbimet qeveritare, përfshirë edhe mbrojtjen e policisë, kujdesin shëndetësor etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa dhe dobësia e liderit "legjitim" krijon vakume të cilat lehtë i plotësojnë liderët radikal ekstremist me vizion dhe qëllime anti shtetërore dhe anti kombëtare</li> </ul>

KKPEDhLKT identifikuan disa faktorë të cilët mund të kontribuojnë për vazhdimin ose rritjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Republikën e Maqedonisë. Këta faktorë rezultojnë nga hulumtime dhe u analizuan në punëtoritë e mbajtura me ndërmjetësim të Ambasadave të SHBA-ve,



Mbretërinë e Bashkuar, Mbretërinë e Holandës, Misionin e BE-së në RM, OSBE, dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare, ndërkaq janë me qëllim të mbështesin me informata relevante procesin strategjik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe potencialin për veprim të dhunshëm.

## **RADIKALIZIMI NË BURGJET**

Republika e Maqedonisë përballet me proces të radikalizmit në burgjet. Kjo në veçanti vlen për popullatën e burrave të rinj, të moshës prej 18 - 24 vjeç, të cilët përderisa janë në burg, mund të radikalizohen nga grupe dhe autoritete me ndikim, nacionalistë, ideologë fetar dhe të tjerë. Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve, është aktive në kuptimin e implikimeve të radikalizmit në burgje dhe u bashkëngjiti KKPEDhLKT që të vazhdojë të punojë me prokurorinë dhe me ministrinë të tjera që të parashikojë masa dhe të zbatojë masa si përgjigje ndaj shenjave të identifikuar të radikalizmit. Në aktivitetet e saj planifikohet trajnim i stafit të burgjeve në mënyrë që ata të mund të parandalojnë dhe mbrojnë të dënuarit nga ndikimi i radikalizmit dhe të merren drejtpërdrejt me të burgosurit që janë radikalizuar dhe të cilët mund të përbëjnë kërcënim për veten ose të burgosurit e tjerë.

## **NEVOJA PËR BASHKËPUNIM**

KKPEDhLKT e kupton se veprimi kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është me rëndësi esenciale për suksesin e tij. Gjatë zbatimit, anëtarët i identifikuan ato ministri në nivel shtetëror dhe lokal, pjesëtarë të policisë në komunitet dhe aktorë të tjerë relevantë, duke përfshirë OJQ-të, udhëheqësit fetarë dhe përfaqësuesit e shkollave, të cilët duhet ti bashkohen përpjekjeve të krijuar qëllim gjithëpërfshirës që do ta vendosë kornizën, me qëllim tua lehtësojë qytetarëve zgjedhjen të mos nisen shtigjeve të ekstremizmit. Kohezioni dhe përkushtimi i këtij grupi i jep Republikës së Maqedonisë "përparësinë" në rajon, që të mundet edhe më tutje të parandalojë dhe ti mbrojnë qytetarët e saj nga bashkimi në ekstremizëm të dhunshëm.

## **PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE UDHËHEQËSVE FETAR LOKAL**

Ekzistenca e nismave në nivel lokal i jep shoqërisë civile një rrugë për kontribut pozitiv nëpërmjet të gjitha formave të udhëheqjes. Angazhimi i shoqërisë civile hap një rrugë që dërgon më larg promotorëve të izolimit, e kultivon rezistencën ndaj thirrjeve ekstremiste dhe ndikimeve. Përpjekjet që nuk janë të politizuara dhe janë të besueshme kanë potencialin të hapin vend për gjetjen e një baze të përbashkët, duke lejuar ndërveprimin në komunitet gjithëpërfshirës.

- Liderë fetarë lokalë të caktuar, paraqesin plotësim të rëndësishëm të narrativave të të kthyerve nga betejat e huaja dhe anëtarët e familjes, duke ofruar një platformë për të përforcuar mesazhet e tyre anti-ekstremiste, duke i dhënë besueshmëri shtesë me autoritetin e tyre intelektual dhe social.
- Të inkurajohet angazhimi i njerëzve të veprojnë në shkaqet rajonale dhe globale, si kundërpeshë e faktorëve që kontribuojnë mjediset të jenë vunerabile (rrezikuara) ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
- Të inkurajohen aktivitete të organizatave civile të orientuara kah të rinjtë, me mundësi për përfshirjen e tyre në programe rinore, me të cilat kanalizohet ndjenja e optimizmit, ndërsa të reduktohet ndjenja e marginalizimit politik, pesimizmi ekonomik dhe izolimi social.

## INICIATIVA TË TJERA NË RRJEDHË

Iniciativa “Shkollë për nënat” (*Mothers School Model*) në Republikën e Maqedonisë hapi mundësi për avancimin e besimit mes anëtarëve të komunitetit që është një koncept themelor për kapërcimin e stigmës dhe tabutë që lidhen me ekstremizmin dhe terrorizmin e dhunshëm. Në fillim, shumë nëna ishin të pavendosura të bashkoheshin në projektin, fillimisht për shkak të polemikave mbi përmbajtjet e temës dhe implikimet që mund të dalin në rrethin ku jetojnë. Ato që e kryen programin arritën një ndjenjë krenarie për arritjen e tyre dhe ndërtuan ndjenjë të fuqishme të miqësisë, vetëbesimit dhe hapjes në komunikimin e tyre të ndërsjellë.

Iniciativat e tjera kanë të bëjnë me:

- Trajnim për gazetarë kur informojnë për tema në lidhje me radikalizmin dhe terrorizmin.
- Bashkëpunim i ngushtë me autoritetet lokale dhe shoqërinë civile.
- Bashkëpunimi me autoritetet shtetërore dhe lokale për të identifikuar lidhjen me krimin e organizuar dhe terrorizmin, përfshirë rrezikun e shitjes së pasaportave të rreme për luftëtarët e huaj terroristë, ndihmën ose kontrabandimin e luftëtarëve të huaj terroristë në transit nëpër Republikën e Maqedonisë, si dhe kontrabandimin e armëve të zjarrit, parave, njerëzve dhe lëvizjet e tjera të paligjshme drejtë Ballkanit dhe nga Ballkani Perëndimor në vendet e BE-së apo gjetkë, të cilat janë përfshirë me aktivitete terroriste.
- Të iniciohen dhe të mbi ndërtohen projektet kërkimore në terren dhe ndikimi i medias mbi rekrutët potencial dhe persona të tjerë të prirë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
- Të zhvillohen masa për de-radikalizimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe të tjerëve që mund të jenë bërë viktima të ideologjive ekstremiste<sup>16</sup>.

## PRIORITETET E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE

Republika e Maqedonisë i harmonizoi dy Strategjitë Kombëtare dhe planet përkatëse të veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit në katër (4) **PRIORITETE STRATEGJIKE** si vijon:

1. **TË PARANDALOHEN** fluksi i luftëtarëve të huaj terroristë, militantë dhe shkaqet rrënjësore për radikalizëm dhe ekstremizëm;
2. **TË MBROHEN** qytetarët, prona e tyre, infrastruktura kyçe dhe kritike nga kërcënimet e pranishme dhe të qarta, si dhe kërcënimet në rritje;
3. **TË NDIQEN** kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në rrënjët e tyre, në strehimoret e sigurta dhe në vendet ku ata përbëjnë rrezik të qartë për qytetarët dhe infrastrukturën; ato kërcënime të ndiqen penalisht në mënyrë aktive, por në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe në përputhje me sundimin e ligjit;
4. **TË REAGOHET** në mënyrë aktive, në mënyrë agresive, por gjithmonë në mënyrë që është transparente dhe në përputhje me sundimin e ligjit, në frymën e solidaritetit dhe në mënyra që minimizojnë pasojat e sulmit terrorist, përmes përmirësimit të aftësive të institucioneve për t'u marrë me situatën pas sulmit, koordinimi i reagimit dhe nevojave të viktimave.

---

<sup>16</sup> Megjithëse ka pasur rënie të luftëtarëve të huaj nga viti 2015, të rinjtë në Republikën e Maqedonisë po përballen me hapësirë të pamjaftueshme shoqërore për t'u larguar nga polarizimi i myslimanëve konservatorë dhe jo konservatorë. Mungesa e kohezionit dhe e të kuptuarit mund të çojë në izolim më të madh shoqëror, i cili është një nga faktorët kryesorë në rrugën e luftëtarëve të huaj terroristë, veçanërisht te të rinjtë që mund të jenë të prekshëm ndaj zërave dhe ndikimeve ekstreme.

## **AKTORËT**

Aktivitetet e mësipërme duhet të zbatohen nga institucionet e përfshira në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë, por jo të kufizohen në: Ministrin për Arsim dhe Shkencë, Ministrin e Vetëqeverisjes Lokale, BNJVL, Ministrin e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencionin për Rini dhe Sport, Komisionin për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive Fetare dhe Grupeve Fetare, si dhe institucione të tjera të përfshira në punën e Komitetit Kombëtar. Një rol shtesë për PEDh ka gjithashtu shoqëria civile e udhëhequr nga OJQ-të, udhëheqësit fetarë, komunitetet lokale, të rinjtë, gratë, mediat etj.

## **KOORDINIMI DHE OPERACIONET**

"Koordinimi" nënkupton përfshirjen e përbashkët të të gjitha institucioneve relevante në Republikën e Maqedonisë - dhe atë në nivel shtetëror, lokal dhe komunal - për shkëmbimin në kohë të informacionit, si dhe bashkëpunimin me qëllim zbulimin, përcaktimin, vlerësimin dhe ndërprerjen e kërcënimeve të mundshme nga terroristët dhe / ose organizata terroriste.

Koordinimi do të sigurojë shkëmbim në kohë të informacionit, shpërndarje të drejtë dhe adekuate të resurseve, planifikim strategjik dhe sinkronizim të bashkëpunimit me institucionet përkatëse shtetërore, lokale, rajonale dhe ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.

Bashkëpunimi midis shërbimeve në nivel operacional do të intensifikohet nëpërmjet formimit të ekipeve të përbashkëta të integruara.

## **REZULTATET E PRITURA**

Realizimi i aktiviteteve të parashikuara këtu do të mundësojë:

- Kuptimi i rreziqeve nga marginalizimi, vështirësitë ekonomike dhe kërcënime nga ndarja e komunitetit;
- Përmirësim i besimit në komunitetet dhe ndërmjet komuniteteve dhe policisë dhe organeve të tjera qeveritare;
- Më pak frikë nga tabu në komunitete që fokusohen ekskluzivisht në grupe specifike etnike ose fetare;
- Arritja e një niveli më të lartë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe lokale në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm;
- Konvertimi drejt standardeve ndërkombëtare dhe harmonizimi i legjislacionit dhe rregulloreve kombëtare me Bashkimin Evropian, OKB-në, OSBE-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

## **ZBATIMI: PLANIFIKIMI I VEPRIMIT PËR PEDh dhe LKT**

Miratimi i Strategjive Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit (2018-2022) është kompetencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Këto strategji hartohen dhe rishikohen nga KKPEDhLKT në bazë të analizës paraprake të rreziqeve të mundshme për të adresuar fenomenin e ekstremizmit, radikalizmit dhe faktorëve të tjerë dhe promotorëve që mund të çojnë në terrorizëm.

Këto dokumente strategjike janë subjekt i një procesi të vazhdueshëm dhe transparent të përpilimit, rishikimit, adoptimit, zbatimit dhe monitorimit.

Objektivat e planifikimit të veprimit në parandalimin e radikalizmit dhe radikalizmit, ekstremizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm dhe aktivitete terroriste janë të përshtatura në:

- Përshkrimi i saktë i këtyre fenomeneve dhe përcaktimi i balancës së drejtë ndërmjet qasjes parandaluese, shqetësuese apo represive;
- Reduktimi i efekteve të terrorizmit.

Dy komponentë kryesorë për realizimin e katër prioriteteve strategjike janë: (1) përmirësimi i aftësive dhe kapaciteteve institucionale për t'i identifikuar dhe zbuluar individët, grupet dhe faktorët e tjerë me efekt radikal në mjedisin e tyre; dhe (2) përmirësimin e aftësive dhe kapaciteteve institucionale për të reduktuar efektet e indikatorëve të radikalizmit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm dhe në fund të fundit në aktivitete terroriste.

Me zbatimin e masave administrative, gjyqësore dhe socio-parandaluese kundër individëve që përhapin ide radikale dhe të dhunshme, do të mundësohet një qasje gjithëpërfshirëse kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe kërcënimeve të terrorizmit në shoqërinë tonë .

## **OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE**

Analiza SWOT e *Përparësitë-Dobësitë-Mundësitë-Kërcënimet (Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats, SWOT)* na mundësoi të shqyrtojmë dhe zhvillojmë shumë prioritete strategjike që janë të përbashkëta dhe vendimtare për të dyja misionet PEDh dhe LKT.

Për PEDh-të, KKPEDhLKT ka identifikuar 4 objektive specifike të Parandalimit, 2 objektiva për Mbrojtje, 1 objektivë të re specifike për PEDh për Ndjekje dhe 3 objektive për Përgjigje.

Për LKT, Republika e Maqedonisë ka 8 objektiva strategjike për parandalim, 5 për mbrojtje, 4 për ndjekje dhe 3 për përgjigje. KKPEDhLKT gjithashtu ka përpiluar dhe miratuar një protokoll relativisht të ri për zbatim - e një kornize të re operative, në përputhje me standardet e NATO-s për zbatimin e linjave të aktiviteteve tona PURSUE në një mënyrë të përmirësuar graduale dhe të kontrolluar: Përçarje - Degradim-Zbërthim- Ndjekje (*Disrupt—Degrade—Dismantle—Pursue*).<sup>17</sup>

KKPEDhLKT ka ndarë mënjanë qëllimet specifike Shtetërore / Kombëtare ("objektivat") për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm:

---

<sup>17</sup> Këto janë terme të reja doktrinare. DISRUPT - Pengimi i organizimit të një grupi terrorist dhe dinamika e saj operacionale pa kontestim fundamental ose aftësisë së tyre për të kryer operacione të ardhshme; DEGRADE - degradim, duke shtypur aftësinë e një grupi terrorist të kryejë operacione në shkallë të gjerë, si dhe duke ja humbur lirinë e lëvizjes së grupit; DISMANTLE - ta zbërthesh, duke e dëmtuar grupin terrorist në një pikë kur ai nuk mund të funksionojë më si një organizatë kohezive; DEFEAT - ta mposhtësh, duke eliminuar grupin terrorist nga streha e tij e sigurt dhe duke parandaluar riformimin e grupeve terroriste të rivendosin strehë të sigurt dhe të rigjenerohen me kalimin e kohës.

TABELA 3. OBJEKTIVAT SPECIFIKE PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

## AKTIVITETET SPECIFIKE PËR ZBATIM

### Zbatimi:

PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
1. PARANDALIMI
Qëllimi strategjik 1.1: Forcimi i kapaciteteve institucionale
Qëllimi strategjik 1.2: Ngritja e vetëdijes publike
Qëllimi strategjik 1.3: Komunitet i fortë dhe rezistues
Qëllimi strategjik 1.4: Parandalimi i radikalizmit përmes internetit
2. MBROJTJA
Qëllimi strategjik 2.1: Institucionet proaktive në drejtim të mbrojtjes së vlerave themelore të të drejtave dhe lirive të njeriut
Qëllimi strategjik 2.2: Rritja e besimit ndërmjet institucioneve relevante dhe qytetarëve për mbrojtjen nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm
3. EKZEKUTIMI
Objektivi strategjik 3.1: Janë vendosur një sërë masash për zbulimin e hershëm të radikalizimit
4. PËRGJIGJA
Qëllimi strategjik 4.1: De- radikalizmi
Qëllimi strategjik 4.2: Ri-integrimi përmes ri-socializimit dhe rehabilitimit
Qëllimi strategjik 4.3: Koordinimi dhe bashkëpunimi

Për zbatimin e Strategjive Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të përpilojë procedura dhe rregullore të përshtatshme.

KKPEDhLKT kryeson iniciativën për zbatimin e Planeve të Veprimit (me kontribut nga institucionet përkatëse dhe ministrinë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë) dhe është përgjegjës për koordinimin dhe komunikimin e përpjekjeve të LKT-së dhe PEDh.

## KORNIZA DHE QASJA E PËRGJITHSHME

Qëllimet e Planeve të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit përfshijnë qasje të integruar dhe të përbashkët të mbështetur nga KKPEDhLKT dhe përmes koordinimit dhe menaxhimit të Grupeve të Punës Shtetërore (GPSH) dhe grupeve operative të punës integruara Task Forces (të përhershme, tematike ose ad hoc). Secili grup punues i krijuar koordinohet nga një ministri udhëheqëse (bartëse e aktiviteteve).

Përveç kësaj, KKPEDhLKT rekomandon krijimin e Grupeve të Veçanta për Luftimin e Terrorizmit me qëllim të sigurimit të punës efikase në terren.

FIGURA 10. QËLLIMI KOORDINUES I TË GJITHË QEVERISË / E GJITHË SHOQËRIA




Figura 10 përshkruan shkurtimisht disa nga parimet bazë dhe qëndrimet e qasjes tonë të propozuar organizative si KKPEDhLKT për përpjekjet e zgjeruara dhe të lehtësuara të "harmonizuara" për të luftuar ekstremizmin dhe terrorizmin e dhunshëm si një trup kolektiv.

Ne propozojmë të fuqizohen grupet e punës ndër-institucionale (në nivel kombëtar dhe komunal, aty ku është e përshtatshme) për të planifikuar, zbatuar, vlerësuar dhe rekomanduar rishpërndarjen e resurseve tek autoritetet shtetërore ... si dhe për të monitoruar "bashkimin" e informacioneve dhe integrimin e përmirësuar për fusha specifike tematike të "efekteve transformuese".

## PRIORITIZIMI

KKPEDhLKT, duke punuar me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve dhe ministrive të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që marrin pjesë në aktivitetet e PEDh dhe LKT, identifikuan pesë (5) prioritetet kritike për "ndërtimin e kapaciteteve partnere", më të përshtatshme për investime jo proporcionale nga bashkësia ndërkombëtare donatore dhe për ekspertizën tematike dhe mbështetjen me ndihmë teknike:



### **Prioritete për financim për vitin e parë, për PEDh dhe LKT:**

1. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale të KKPEDhLKT
2. Përmirësimi i standardizimit nëpër platformat rajonale për shkëmbimin e të dhënave, përfshirë përpunimin e të dhënave; Krijimin e një programi dinamik dhe bazë të të dhënave, bazuar në analizën e rrjetit, për t'i përcaktuar kërcënimet që përshkallëzohen
3. Ngritja e Ekipeve të Veprimit në Komunitetet (EVK) për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve shtetërore, lokale dhe komuniteteve lokale, përmirësimin e trajnimit të punës policore në komunitet dhe prezencë
4. Themelimi i Grupeve Speciale të Integruara (Integrated Task Forces ITFs), përfshirë Task Forcën e Përbashkët Terroriste të Maqedonisë (MKD-JTTF) për përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin dhe reagimin ndaj veprimeve kritike
5. Themelimi i Grupeve të Punës Shtetërore (GPSH) për veprime të përqendruara me shumë agjenci rreth kësaj: Krijimi i Strategjisë Rajonale për PEDh dhe LT për Ballkanin Perëndimor, të udhëhequr nga MKD; Përfundimi i një sistemi të plotë për mbikëqyrje dhe kontroll kufitar

Projektimi i ndërtimit të mëtejshëm të kapaciteteve në bazë të nevojave dhe kërkesave, KKPEDhLKT ka identifikuar përbërjen e mëposhtme të objektivave specifike për PEDh dhe LKT (dhe aktivitetet përkatëse të matshme) si prioritete kryesore për qëllimet në vitet 2 deri në 5:

### **Prioritete për financim për vitet 2 deri në 5, për PEDh dhe LKT:**

- Parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimit të terroristëve duke forcuar bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar (LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.5; PEDh QËLLIMI STRATEGJIK 2.2}
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për ballafaqimin me "luftëtarët e huaj terroristë" {LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.4} në lidhje me një sërë masa të caktuara për zbulimin e hershëm të radikalizimit { PEDh QËLLIMI STRATEGJIK: 3.1 }
- Parandalimi i radikalizimit nëpërmjet internetit {LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.3; PEDh QËLLIMI STRATEGJIK 1.4}
- Parandalimi i financimit të terrorizmit {LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.2}
- Përmirësimi i kapaciteteve përmes vlerësimeve, analizave dhe hulumtimeve në lidhje me radikalizimin dhe terrorizmin {LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.6; PEDh QËLLIMI STRATEGJIK 1.1}
- Forcimi i sistemeve të kontrollit të kufirit shtetëror (LT QËLLIMI STRATEGJIK: 2.1}
- Përmirësimi i koordinimit ndërqeveritar { LT QËLLIMI STRATEGJIK: 1.5; PEDh QËLLIMI STRATEGJIK 2.2}
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve relevante për t'iu përgjigjur sulmeve terroriste (LT QËLLIMI STRATEGJIK 4.1; PEDh QËLLIMI STRATEGJIK 4.3}

## **MONITORIMI dhe VLERËSIMI PËR PEDh**

Institucionet përgjegjëse janë të detyruara të përmbushin detyrimet e Planeve të Veprimit për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara. Institucionet përgjegjëse do të raportojnë për nivelin e zbatimit për KKPEDhLKT.

KKPEDhLKT do të informojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë një herë në vit për statusin e realizimit të aktiviteteve të parapara në Strategjitë Kombëtare, gjegjësisht Planet e Veprimit.

Raporti gjithashtu do të përmbajë përfundime për institucionet e tjera relevante që nuk i kanë kryer aktivitetet sipas orarit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

Organet mbikëqyrëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm do të përcaktohen në kuadër të Ministrisë për Arsim dhe Shkencë, Ministra e Vetëqeverisjes Lokale, BNJVL, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia për Rini dhe Sport, Komisioni për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive Fetare dhe Grupeve Fetare, si dhe institucione të tjera të përfshira në punën e Komitetit Kombëtar.

**MATJA E PROGRESIT:** Qëllimi i procesit të vlerësimit është i dyfishtë: 1) i japin vendimmarrësve në Republikën e Maqedonisë informacionin e nevojshëm për priorizimin dhe shpërndarjen e drejtpërdrejtë të resurseve dhe përpjekjeve dhe 2) të informohen vendimmarrësit në nivel kombëtar, përmes raportimit të integruar.

## **RI KALIBRIMI**

Strategjia parashikon zbatimin e aktiviteteve dhe masave të planifikuara në periudhën prej pesë (5) viteve, d.m.th., 2018-2022.

Fondet e nevojshme për zbatimin e kësaj strategjie do të mbulohen nga projektet dhe nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, i cili gjithashtu do të bëjë një vlerësim financiar, si dhe mbështetje nga donatorë ndërkombëtarë.

Harmonizimi i resurseve - dy parime të përgjithshme:

- Shtytja e procesit të llogaridhënies për resurset më poshtë, në nivelin më të ulët operativ; dhe
- Maksimizimi i përpërsisë krahasuese të secilit lloj të mjeteve të resurseve.

## **AGJENDA HOLISTIKE PËR VEPRIM: Planifikimi i veprimit për parandalimin "gjithëpërfshirës" të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit**

Siç fillon ky dokument strategjik, ashtu edhe përfundon: duke diskutuar imperativat për të dalluar mes qëllimeve, mënyrave, metodave dhe mjeteve për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, njëkohësisht duke ndërtuar dhe gjetur burime për zbatimin e Planeve të Veprimit me një filozofi gjithëpërfshirëse dhe holistike dhe një sërë metodash për parandalimin dhe luftimin e tyre .

Qasja e Republikës së Maqedonisë në këto Strategji Kombëtare dhe më e rëndësishmja për Planet përkatëse të Veprimit, bën thirrje dhe paraqet synimet dhe përpjekje për *zbatimin e balancuar* të Strategjive Kombëtare të Republikës së Maqedonisë për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Terrorizmit të Dhunshëm ... në përputhje me qasjen ndaj parimeve të strategjive dhe plan veprimeve të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian.

Ndërsa Strategjitë Kombëtare po shndërrohen në plane veprimi, Republika e Maqedonisë do të vazhdojë përpjekjet tona të organizuara për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, në rrënjët dhe pikat e krijimit të tij, me mund dhe vëmendje të veçantë ndaj gatishmërisë, parandalimit dhe reagimit. Republika e Maqedonisë është e përkushtuar të zgjerojë përgjigjet, angazhimin e hershëm me rreziqet, kërcënimet dhe trajtimin e indikatorëve të ekstremizmit të dhunshëm; dhe faktorët që shpesh çojnë në terrorizëm dhe aktivitete terroriste.



Republika e Maqedonisë do të plotësojë parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me masa parandaluese. Marrja e parandalimit si pjesë integrale e një qasjeje gjithëpërfshirëse do të ndihmojë në angazhime me parakushtet që i theksojnë individët që të bashkohen me grupet e dhunshme ekstremiste; në vetvete, qasja parandaluese për të luftuar terrorizmin është e orientuar drejt "shenjave të hershme": Ashtu si me praktikën e parandalimit në përgjithësi, rezultatet mund të mos jenë menjëherë të dukshme dhe do të kërkojnë angazhimin tonë afatgjatë dhe të durueshëm.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> E nxjerrë nga "Strategjia e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Terrorizmin, Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm", *Raport i Sekretarit Gjeneral*, 24 dhjetor 2015, f. 10.